



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 954/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Nuk akreditohet** në nivel institucional Kolegji UBT dega në Gjilan.
- II. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore në rast të moszbatimit të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji UBT në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të degës në Gjilan në nivel institucional.

AKA me datën 10.03.2022 ka organizuar vizitën me ekspertët ndërkombëtarë për akreditim ; Dietmar Paier, Drazen Vrhovski dhe Asnate Kazoka.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe ka dhënë konstatimet si në vijim: nga njëmbëdhjë fusha të standardeve të akreditimit, është vlerësuar se i përmbush: substancialisht një (1) standardë dhe pjesërisht dhjetë (10) standarde që nënkupton se IAL nuk i përmbushë standardet dhe kriteret e kërkuara për akreditim institucional.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegji UBT dega në Gjilan dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji UBT dega në Gjilan;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë